

L I G J
Nr.7537, datë 17.12.1991

PËR DISA NDRYSHIME NË KODIN E PROCEDURËS CIVILE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7991, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore Kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në Kodin e Procedurës Civile, neni 1 ndryshohet si vijon:

"Legjislacioni procedural civil i Republikës së Shqipërisë shpreh vullnetin e popullit dhe ka për detyrë të mbrojë rendin kushtetues, të drejtat dhe interesat e ligjshme të personave fizikë e juridikë, të parandalojë mosmarrëveshjet civile dhe shkeljet e ligjit, si dhe të ndihmojë për edukimin e shtetasve me frymën e respektimit të ligjeve.

Legjislacioni civil cakton rregulla të detyrueshme për gjykimin e çështjeve civile".

Neni 2

Neni 4 ndryshohet si vijon:

"Bazat dhe parimet kryesore të legjislacionit procedural civil".

Legjislacioni procedural civil bazohet në dispozitat kushtetuese të Republikës së Shqipërisë dhe i përmbahet parimit të ligjshmërisë, në bazë të të cilit organet e drejtësisë janë të detyruara të zbatojnë rregulla të njëjta e të barabarta, të gjykojnë në mënyrë objektive, të plotë e të gjithanëshme, me qëllim që mosmarrëveshjet civile të zgjidhen drejt dhe në përputhje me ligjet".

Neni 3

Neni 5 ndryshohet si vijon:

"Gjykata është organi që realizon dhënien e drejtësisë. Ajo vepron me trup gjykues, të përbërë nga një gjyqtar e dy ndihmësgjyqtarë ose nga një gjyqtar. Për çështjet e kompetencës së tij gjyqtari zbaton të gjitha rregullat që ky kod parashikon për gjykatën.

Gjykata merr të gjitha masat për një gjykim të drejtë e të shpejtë të çështjeve civile, për zbulimin e së vërtetës dhe ndihmon pjesëmarrësit në procesin civil që të mos dëmtohen nga padijenja e ligjit.

Gjykata, në gjykimin e çështjeve, është e pavarur dhe vendos vetëm në bazë të ligjit".

Neni 4

Paragrafi i fundit i nenit 11 ndryshohet si vijon:

"Gjykata me kërkesën e palëve të interesuar ka të drejtë të thërrasë si person të tretë çdo person, me të cilin ajo mendon se e ka çështjen të përbashkët".

Neni 5

Neni 12 ndryshohet si vijon:

"Persona të interesuar mund të jenë personat juridikë e fizikë, të cilët kanë interes për zgjidhjen e një çështje që është në gjykim.

Neni 6

Në paragrafin e parë të nenit 43 hiqen fjalët "vlerësimin politiko-shoqëror të mosmarrëveshjeve civile".

Neni 7

Paragrafi i parë i nenit 62 ndryshohet si vijon:

"Çështjet civile në shkallë të parë shqyrtohen nga një gjyqtar, me përjashtim të atyre që shqyrtohen nga gjykata me trup gjykues.

Me trup gjykues shqyrtohen këto çështje:

- Paditë për njohjen dhe kundërshtimin e atësisë.
- Paditë për kërkimin dhe pjestimin e pasurive të palujtshme, për mosmarrëveshjet kontraktore që nuk janë në kompetencë të arbitrazhit dhe për shkarkimin e dëmit, kur vlefta e tyre padive është mbi pesëdhjetë mijë lekë".

Neni 8

Në paragrafin e parë të nenit 155, pas fjalëve "gjendjes civile" shtohet fjalët "dhe i njohjes së pronësisë".

Neni 9

Paragrafi i dytë i nenit 195 ndryshohet si vijon:

"Kur është nevojshme, përmbaruesi gjyqësor mund të hapë banesën e të detyruarit, duke qenë të panishëm dy dëshmitarë të paanshëm".

Neni 10

Në nenin 199 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Për kreditë në bankë, ekzekutimi bëhet nga banka me vendim të përmbaruesit".

Neni 11

Në nenin 201 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Kur sendi i palujtshëm, për të cilin është dhënë vendim, nuk është liruar vullnetarisht nga debitori brenda afatit të caktuar, përmbaruesit gjyqësor i njofton debitorit ditën dhe orën, në të cilën do të vërë kreditorin në posedim të sendit.

Kur përmbaruesi gjyqësor vëren se sendi i palujtshëm ndodhet në posedim të një personi të tretë që ka fituar për vetë posedimin e sendit pas fillimit të çështjes për të cilën është dhënë vendim që ekzekutohet, e vë kreditorin në posedim të sendit".

Neni 12

Paragrafi i dytë i nenit 203 ndryshohet si vijon:

"Sekuestrimi i sendeve të palujtshme të debitorit bëhet me regjistrimin në zyrën e hipotekave ose të kadastrës të aktit të përmbaruesit gjyqësor, në të cilin shënohet lloji, natyra dhe të paktën tre kufijtë e sendit të palujtshëm vendi ku ndodhet, si dhe hipoteka dhe barrën që mund të jenë vënë mbi të".

Neni 13

Pas nenit 206 shtohet neni 206/a me këtë përmbajtje:

"Pas sekuestrimit të pasurisë së palujtshme, përmbaruesit gjyqësor njofton debitorin që sendet

e sekuestruara do të shiten në ankand, në qoftë se brenda 10 ditëve ai nuk ekzekuton detyrimin.

Shpallja për shitjen në ankand afishohet në zyrën e përmbaruesit gjyqësor dhe në vendin ku ndodhet sendi. Shitja nuk mund të bëhet para se të kenë kaluar 15 ditë nga shpallja. Ajo vazhdon 15 ditë dhe çdo ofertues duhet të lërë si garanci një shumë të hollash baraz me 10 për qind të çmimit të sendit".

Neni 14

Shtohet neni 206/b me këtë përmbajtje:

"Për ankandin mbahet një procesverbal, në të cilin ofertuesi shënojnë çmimin që japin për sendin. Blerësi i sendit quhet ofertuesi që ka dhënë çmimin më të lartë, por pronësia mbi sendin i kalon blerësit pasi të paguajë të gjithë çmimin.

Blerësi duhet të paguajë çmimin e sendit të blerë brenda 15 ditëve nga mbarimi i ankandit. Në rast se blerësi nuk paguan brenda këtij afati, shumta e lënë prej tij si garanci kalon në dobi të shtetit dhe për shitjen e sendit bëhet një ankand i ri".

Neni 15

Shtohet neni 206/c me këtë përmbajtje:

"Në rast se në ankandin e parë nuk është bërë shtesë mbi çmimin me të cilin ka filluar shitja, ose nuk është paraqitur asnjë ofertues, për shitjen e sendit bëhet një ankand i ri, i cili fillon pasi të kenë kaluar tre muaj nga mbarimi i ankandit të parë, në bazë të një çmimi më të ulët jo më të vogël se 20 për qind të çmimit të para caktuar nga përmbaruesi gjyqësor në marrëveshje me debitorin.

Nëse edhe në ankandin e ri sendi nuk shitet, përmbaruesi i propozon kreditorit që, kundrejt kredisë, të marrë sendin me çmimin e caktuar për ankandin e ri dhe, kur ky refuzon, hiqet sekuestroja mbi sendin".

Neni 16

Shtohet neni 206/d me këtë përmbajtje:

"Kur kreditorët që kërkojnë të marrin sendin kundrejt kredisë janë shumë, përmbaruesi gjyqësor deklaron si blerës atë kreditor që brenda tre ditëve nga noftimi jep një çmim më të lartë se çmimi i caktuar për ankandin e ri".

Neni 17

Shtohet neni 206/e me këtë përmbajtje:

"Kur ekzekutimi bëhet për një send që është në bashkëpronësi për detyrimin e ndonjërit nga bashkëpronarët sekuestrohet dhe shitet vetëm pjesa e bashkëpronarit debitor, por mund të shitet edhe i gjithë sendi, kur për këtë japin pëlqimin bashkëpronarët e tjerë".

Neni 18

Shtohet neni 206/dh me këtë përmbajtje:

"Kundër shitjes në ankand mund të bëhet ankim në bazë të nenit 214 të këtij kodi".

Neni 19

Në nenin 207 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Kur kredia e sekuestruar është siguruar me peng, personi që mban sendin mbi të cilin është vënë peng, detyrohet të mos ia dorëzojë këtë send asnjë personi pa aurdhërin e përmbaruesit gjyqësor. Kur kredia e sekuestruar është siguruar me hipotekë, në regjistrin e zyrës së hipotekës ose të kadastrës duhet bërë shënim për sekuestrim".

Neni 20

Nenet 2, 3, 6 paragrafi i dytë, 74 paragrafi i dytë 84 paragrafi i katërt, 128 paragrafi i tretë, 182 paragraf i katërt, 192 paragrafi i dytë dhe 200 shfuqizohen.

Neni 21

Dispozitat ligjore që janë në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 22

Ky ligj në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.98, datë 25.12.1991 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë Ramiz Alia